



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 418/1 prot.

Tiranë më 12.03.2020

Lënda: Mbi kërkesën për informacion drejtuar shoqërive "Albtelecom" SHA, "Telecom Albania" SHA dhe "Vodafone Albania" SHA

**Z. Ardi Veliu**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT**  
**Tiranë**

**Për dijeni: SHOQËRISË "ALBTELECOM" SHA**  
**Tiranë**

**SHOQËRISË "TELEKOM ALBANIA" SHA**  
**Tiranë**

**SHOQËRISË "VODAFONE ALBANIA" SHA**  
**Tiranë**

**AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**Tiranë**

I nderuar zoti Veliu,

Zyra e Komisionerit u njoh me shkresën tuaj nr. 2012 Prot., të datës 12.03.2020, drejtuar shoqërive "Albtelecom" SHA, "Telekom Albania" SHA dhe "Vodafone Albania" SHA.

Duke marrë parasysh kërcënimin serioz që paraqet përhapja e virusit COVID-19 në Shqipëri, si dhe rëndësinë e masave që kanë ndërmarrë dhe synojnë të ndërmarrin institucionet ligjzbatuese, përfshirë Policinë e Shtetit, në drejtim të parandalimit dhe minimizimit të pasojave të rënda për jetën dhe shëndetin e qytetarëve, Zyra e Komisionerit vlerëson se kërkesa, drejtuar kontrolluesve “Albtelekom” SHA, “Telekom Albania” SHA dhe “Vodafone Albania” SHA, është e bazuar në kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave personale të parashikuara nga shkronjat “c” dhe “d” të pikës 1, në harmoni me pikën 2, të nenit 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Më tej, Zyra e Komisionerit gjen me vend të sjellë në vëmendje të Policisë së Shtetit detyrimin e saj për të përpunuar të dhënat personale, të vëna në dispozicion nga shoqëritë e sipërpërmendura, në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, ku përfshihet, ndër të tjera, detyrimi për fshirjen e të dhënave personale pas periudhës së përpunimit të tyre për qëllimet e deklaruara.

Gjithashtu, Policia e Shtetit duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale të përpunuara, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit inkurajon shoqëritë “Albtelekom” SHA, “Telekom Albania” SHA dhe “Vodafone Albania” SHA, të bashkëpunojnë me Policinë e Shtetit, si dhe me të gjitha institucionet ligjzbatuese të angazhuara në luftën kundër virusit COVID-19, në përputhje me frymën dhe dispozitat detyruese të legjisllacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Duke ju falenderuar për kontributin tuaj,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

